



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 172 datë 21.12.2020

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2021-2023 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronjat “ç” dhe “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 6, shkronjat “ç” dhe “d”, nenit 33, pika 1, nenit 39, pika 1, nenit 40, nenit 41, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 5, shkronjat “a” dhe “d” të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neneve 6, 15, 17 dhe 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; nenit 2, shkronja “c” dhe nenit 5 të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, pikës 17, të vendimit nr.165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; udhëzimit nr.10 datë 28.02.2020, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023”, udhëzimit plotësues nr. 27 datë 10.07.2020, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021-2023”, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2021-2023 si më poshtë vijon:

1.1. Plani i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2021-2023, është në shumat si më poshtë:

Lloji i të ardhurave	Plan 2020	Parashikimi 2021	Në lekë	
			Parashikimi 2022	Parashikimi 2023
Të ardhura të taksueshme	10,017,826,000	9,859,760,000	9,669,898,000	9,774,687,000
Të ardhura jo tatimore	4,606,420,000	4,467,038,000	4,541,902,000	4,619,219,000
Total të ardhura	14,624,246,000	14,326,798,000	14,211,800,000	14,393,906,000
Transferta e pakushtezuar e pergjithshme	2,424,942,357	2,438,116,570	2,532,020,000	2,738,186,000
Transferta e pakushtezuar sektoriale	1,176,039,602	1,368,453,013	1,300,000,000	1,350,000,000
Total Transferta	3,600,981,959	3,806,569,583	3,832,020,000	4,088,186,000
Të ardhura të mbartura	2,178,800,000	2,400,000,000	0	0
Totali	20,404,027,959	20,533,367,583	18,043,820,000	18,482,092,000

1.2. Plani i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2021-2023, është në shumat si më poshtë:

Në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plan 2020	Plan 2021	%	Plan 2022	Plan 2023
Shpenzime personeli	5,940,486,972	6,281,925,428	30%	6,281,925,428	6,281,925,428
Shpenzime te tjera operative	7,185,591,699	7,036,406,074	34%	6,604,865,283	7,711,819,649
Shpenzime kapitale	7,277,949,288	7,215,036,081	35%	5,157,029,289	4,488,346,923
TOTALI	20,404,027,959	20,533,367,583	99%	18,043,820,000	18,482,092,000

2. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2021, si më poshtë:

2.1. Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrës Nr.1, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.2. Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë së Tiranës sipas pasqyrës Nr.2 pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2.3. Të miratojë detajimin e shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrave Nr.3 dhe Nr.3/1 pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.4. Të miratojë planin e shpenzimeve kapitale sipas programeve sipas Pasqyrës Nr.4 pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.5. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2021.

3. Të miratojë Kalendarin e përgatitjes së PBA 2022-2024.

4. Task Forca e ngritur sipas vendimit nr. 45, datë 06.07.2016 të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e task forcës për regjistrimin e asambleve të bashkëpronësisë dhe administratorëve të bashkëpronësisë”, i ndryshuar, vazhdon të funksionojë dhe të ushtrojë funksionin e saj edhe për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga data 1 janar deri më 31 dhjetor 2021.

5. Kontratat me kohëzgjatje të caktuar për 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të Aparatit të Bashkisë me pagë bruto 45,000 lekë/muaj miratohet edhe për një periudhë 12 mujore (01.01.2021-31.12.2021).

6. Kontratat me kohëzgjatje të caktuar për vitin 2021, për 30 (tridhjetë) punonjës me pagë bruto 30 000 lekë/muaj në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, miratohet për një afat 3 (tre) mujor dhe si rregull për periudhën mars – maj.

7. Kontratat me kohëzgjatje të caktuar për vitin 2021, për 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës me pagë bruto 30 000 lekë/muaj në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, miratohet për një afat 3 (tre) mujor dhe si rregull për periudhën maj - korrik, për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes e kullimit, pas periudhës së shirave.

8. Të miratojë një ndryshim në pikën 8, të vendimit nr.38 datë 03.05.2019, “Për miratimin e nivelit të pagave të Njësive Administrative dhe Lagjeve të Bashkisë së Tiranës” duke shtuar 20 ndërlidhës me komunitetin për Njësitë Administrative dhe Lagjet, duke ndryshuar numrin e ndërlidhësve komunitarë nga 223 në 243.

9. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë,

Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe të të Dhënave, si dhe institucionet në varësi të Bashkisë Tiranë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2021.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO